



Asociacioni i Komunave të Kosovës

R A P O R T

nga

Takimi i Kolegjiut për Administratë

Dragash, 10 qershor 2011

Për: Ertan Munoglu – Menaxher i Programit i AKK-së

Nga: Fisnik Dashi – Koordinator i Kolegjumeve të AKK-së

Lënda: Raport nga takimi i Kolegjiut për Administratë

HYRJE

Asociacioni Komunave të Kosovës (AKK) në bashkëpunim me Kryesinë e Kolegjiut për Administratë organizoi takimin e dytë të këtij Kolegjiut me 10 qershor 2011 (e premte) me fillim nga ora 11:00 në Restorant „ Arxhena ” në Dragash.

Takimi kishte për qëllim të diskutohej rendi i ditës i përcaktuar më parë nga Kryesia me këto pika:

- Unifikimi i organogrameve dhe koeficienteve
- Unifikimi i përshkrimeve të vendeve të punës
- Nevojat për trajnim në përpilimin e vendimeve komunale

Në këtë takim morën pjesë Drejtorë të Drejtorive për Administratë të Komunave të Kosovës, si dhe përfaqësues nga Asociacioni i Komunave të Kosovës. Takimi u kryesua nga Kryesuesi i Kolegjiut të drejtorëve të Administratës z. Xhemë Binaku.

PËRMBLEDHJE

Njëra ndër problemet që hasin komunat është edhe ajo e organizimit të zyrave në komunë, duke marrë për bazë se shumë komuna kanë organizimin e brendshëm në forma/zyra të ndryshme është menduar se duhet të ketë një unifikim të këtyre organogrameve nga të gjitha komunat në Republikën e Kosovës.

Mirëpo një sfidë shumë e madhe është mënyra se si do të përcaktoheshin format drejt një unifikimi duke mos krijuar ngarkim të pozitive në organizimin e zyrave në nivel komunal, në mënyrë që të ketë një funksionaliteti dhe efektivitetit më të madh në punë.

Gjatë diskutimit u vërejt se të gjitha komunat kanë forma të ndryshme sa i përket organizimit të zyrave dhe se duhet gjetur një formë e përbashkët e më kreative të unifikimit të tyre. Në takim u konstatua se unifikimi i organogrameve është i domosdoshëm duke marrë parasysh se baza është e njëjta në të gjitha komunat, por do duhej gjetur e përcaktuar forma më e përshtatshme e organizimit sa më funksional të zyrave.

Ishte konstatim i përbashkët i të gjithë pjesëmarrësve se do të jetë shumë i vështirë procesi i arritjes së unifikimit të organogrameve nga të gjitha komunat e Kosovës, sepse në masë të madhe kjo gjë varet prej vetë kryetarëve të komunave. Është e drejtë ekskluzive e kryetarit të komunës në riorganizimin e zyrave në komunë sipas nevojave dhe specifikave të secilës komunë. Këtu gjithashtu përfshihet edhe rregullimi sipas statutit të komunave dhe me këtë rast është shumë vështirë të arrihet një përmirësim dhe rregullim në praktikë.

Nëse mund të ketë unifikimi atëherë kjo duhet të bëhet me ligj apo me akte administrative, kështu që të mos ketë laramani si është për momentin. Duhet të ketë një bashkëpunim më të madh nga vetë drejtorët në mes vete dhe të ketë një komunikim më të fortë në bashkërendimin e aksioneve të përbashkëta. Të ketë një unifikim të qëndrimeve nga Kolegjiut si dhe të paraqiten këto qëndrime në AKK dhe në takimet me zyrtarët e MAPL-së dhe MAP-së. Ministrinë dhe AKK duhet pastaj të

bashkërendisin veprimet e tyre me daljen e ndonjë modeli të përbashkët rreth organogrameve, ku mundësisht të jenë në forma të përgjithshme pastaj komnat në mënyre specifike të përcaktojnë funksionin e tyre sipas nevojave dhe madhësisë të vetë komunave.

Gjatë diskutimit u vërejt edhe problemi i numrit të madh të punësuarve në administratë, gjë që shkakton probleme në efektivitetin dhe përgjegjësinë në punë. Në anën tjetër askush nuk ka guxim të zvogëlojë numrin e punëtorëve në komnat e tyre, dhe në disa raste vazhdohet me rritjen e numrit të kuadrove për të anashkaluar shkaktimin e pakënaqësive tek stafi komunal.

Me këtë rast duhet gjetur forma se si duhet të punohet bashkërisht që të ketë një pasqyrë të organogrameve komunale të cilat do të jenë në përputhje me statutet e tyre dhe të mos shkaktojnë pakënaqësi.

Një ndër problemet të cilat hasin shumë drejtorë komunal është edhe ai i koeficienteve të punëtorëve në sektorët e caktuar. U shpreh qëndrimi se duhet të ketë patjetër një unifikim të koeficienteve në sektorët e ndryshëm të punës në mënyrë që të mos ketë laramani të mëdha në komuna, sepse kjo po shkakton një pakënaqësi dhe mosmarrëveshje tek vetë punëtorët dhe drejtorët. Për këtë arsye duhet të ketë sa më shpejt një unifikim të përshkrimeve të vendeve punëve si dhe koeficienteve të cilat do të përcaktoheshin me ligj.

Gjatë takimit u shpreh edhe pakënaqësia e drejtorëve sa i përket DASHC në MAP i cili ka një rol kryesor sa i përket aprovimit final të koeficienteve të punëtorëve. DASHC-i shkakton aprovonjë koeficientët në baza personale apo presionit politik të kryetarëve.

Të gjithë pjesëmarrësit ranë dakord se duhet të ketë një unifikim të koeficienteve për shërbyesit e administratës dhe së bashku me udhëzimet administrative të përcaktohet me legjislacion koeficienti dhe pozita si dhe përshkrimi i vendit të punës.

Po ashtu u cek se me regjistrimin e ri të popullsisë mund të ndryshojnë gjërat meqë do të ketë një sistem në bazë të të cilit edhe do të përcaktohet numri i punëtorëve sipas numrit të popullatës në komuna. Është një sfidë e madhe dhe duhet të ketë një qasje në mënyrë serioze në bashkërendimin e aksioneve të përbashkëta në të ardhmen si dhe të ketë konsultime të drejtpërdrejta dhe serioze me zyrtarët e ministrisë për problemet që i hasim gjatë punës së përditshme.

Një ndër pikat që u prek ishte edhe ajo se si duhet të vepohet në ato raste kur komnat vetëm kanë përcaktuar pozitat rreth organogrameve si dhe detyrat e përcaktuara të cilat së shpejti do të aprovohen me rregullore komunale në kuvendin komunal si është rasti i Komunës së Gjilanit.

Një ndër vërejtjet ishte edhe se përshkrimi i vendeve të punës duhet të bëhet nga drejtoria dhe jo nga menaxherët e personelit.

Përfaqësuesi nga Gjilani theksoj se Komuna është në përfundim të organizimit të zyrave, sistematizimin e punës dhe përshkrimit të vendeve të punës dhe me këtë rast ata po punojnë në nxjerrjen e rregullores

dhe aprovim në Kuvendin Komunal. Sa do të jetë e vlefshme kjo punë nëse merret vendimi për ndryshim të ri?

KONKLuzionET

- Të ketë një unifikim të qëndrimeve nga Kolegjiumi i cili do të prezantohet në AKK
- AKK pastaj me ministritë përgjegjëse të bashkërendisin veprimet me nxjerrjen e një modeli të përbashkët
- Kryetarët pastaj të vendosin për organogramet e tyre në bazë të nevojave dhe specifikave të komunave të tyre
- Duhet bërë unifikimin e koeficientëve për të gjithë shërbyesit civil dhe nëpunësit tjerë
- Të diskutohet me MAP-në se si do të rregullohet puna e bërë deri tani nga komunat e veçanta si p.sh Komuna e Gjilanit rreth organizimit të zyrave, si dhe sistematizimin e përshkrimin e vendeve të punës